REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/12/23

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka inicuar hetimet preliminare disiplinore sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarëve S.S dhe A.G për shkak të dyshimit të arsyeshëm për shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe neni 7 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 23.06.2023 merr këtë:

V E N D I M

Hedhet rasti i inicuar sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarëve S.S dhe A.G i datës 24.05.2023, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 24.05.2023 Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pranuar në kompetencë nga Këshilli Gjyqësor raportin e Inspektimit nga Njësia për Inspektim Gjyqësor të dy lëndëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, PP.nr.17/2023 dhe PP.nr.18/2023.

Pas shqyrtimit të raportit, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 24.05.2023 ka inicuar sipas detyrës zyrtare hetimet preliminare disiplinore ndaj gjyqtarëve S.S dhe A.G, për të vlerësuar se a ka bazë për inicim të procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Me datë 29.05.2023 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për inicimin e hetimeve preliminare disiplinore ndaj gjyqtarëve S.S dhe A.G.

Nga raporti i datës 05.05.2023 së Njësisë së Inspektimit Gjyqësor[1] rezulton se në lëndën PP.nr.17/23 (2023:070451) të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, në të cilën gjyqtar i çështjes është S.S, me aktvendim i caktohet masa e paraburgimit të pandehurit në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve nga data 19.03.2023 deri më datë 07.04.2023 për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "Dhuna në familje" nga neni 248 par. 3 nën par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së të datës 21.03.2023. Kundër aktvendimit PP.nr.17/23 të datës

[1] Të cilin raport Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë e ka pranuar me datë 24.05.2023 përmes aktpërcjellsit të KGJK me numër 01/526 të datës 24.05.2023.

21.03.2023 është parashtruar ankesë e cila është protokolluar me datë 28.03.2023, e cila ankesë është dërguar përmes postës me datë 24.03.2023. Akt përcjellësi për Gjykatën e Apelit ishte i datës 30.03.2023. Më tej sipas të gjeturave të Raportit të Inspektimit rezulton se lënda PP.nr.17/23 me nr të SMIL 2023:070451, në dosjen fizike të inspektuar ka qenë e kompletuar, aktvendimi i nënshkruar, përveç aktit përcjellës që ishte i pa nënshkruar dhe i pa vulosur, në sistemin SMIL, lënda ishte e regjistruar në afati kohor, me prioritet të lartë, aktvendimi i nënshkruar, ndërsa akti përcjellës i pa nënshkruar, kurse të dhënat e siguruara nga Gjykata e Apelit me anë të shkresave dëshmojnë të kundërtën pasi për herë të parë dokumentet kanë qenë të pakompletuara ndërsa pas përmisimit në sistem, aktvendimi ishte i nënshkruar. Po ashtu nga Inspektimi i lëndës është gjetur se veprimet (dështimet) e gjyqtarit S.S janë: 1. Dosjen e ka dorëzuar të pakompletuar te referenti përgjegjës, 2. Aktvendimi ka qenë i pa nënshkruar dhe i pa vulosur, 3. Akti përcjellës i datës 30.03.2023 me nr. 04138880 sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit të pandehurit nuk ka qenë i nënshkruar dhe i vulosur, 4. Konstatohet se gjyqtari nuk ka vepruar sipas vendimit të KGJK-së nr.424/2021 të datës 29.12.2021 për aprovimin e formës elektronike për procedimin e ankesave në lëmin penale gjatë procedurës paraprake në mes të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe procedimit të ankesave përmes SMIL-it në Gjykatën e Apelit, 5. Si shkelje në vazhdimësi konsiderohet veprimi i mëvonshëm apo nënshkrimi dhe vulosja e aktvendimit nga ana e gjyqtarit e cila ka ndodhur pas kërkesës nga zyrtari përgjegjës i Gjykatës së Apelit drejtuar referentit D.S që të bëhet përmisimi i të dhënave edhe njëherë në sistemin SMIL, 6. Si pasojë e veprimeve të lartcekura për të vepruar sipas afateve të përcaktuara ligjore me rastin e paraburgimit, Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore gjeti se ankesa është jo lëndore.

Sa i përket lëndës PP.nr.18/2023 me numër të SMIL 2023:071497 sipas Raportit të Inspektimit rezulton kjo gjendje faktike: gjyqtar i çështjes në këtë lëndë është A.G. Me aktvendimin e datës 22.03.2023 të pandehurit i caktohet masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, e cila masë llogaritet nga dita e ndalimit 20.03.2023 deri me datë 04.04.2023 për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.1 i KPRK. Kundër aktvendimit për caktimin e paraburgimit është paraqitur ankesa me datë 23.03.2023 dhe me datë 24.03.2023 përmes SMIL-it është përcjellë ankesa me prioritet të lartë dhe tek vërejtja figuron se ankesa është me paraburgim. Më tej sipas të gjeturave të Raportit të Inspektimit rezulton se lënda Pp.nr.18/23 me nr të SMIL 2023:071497, në dosjen fizike të inspektuar ka qenë e kompletuar, aktvendimi i nënshkruar, akti përcjellës i nënshkruar, i vulosur, si dhe nga përmbajtja me prioritet të lartë, sistemin SMIL, lënda ishte e regjistruar në afati kohor, me prioritet të lartë, aktvendimi dhe akti përcjellës ishin të nënshkruara, kurse të dhënat e siguruara nga Gjykata e Apelit me anë të shkresave dëshmojnë të kundërtën pasi për herë të parë dokumentet kanë qenë të pakompletuara ndërsa pas përmisimit në sistem, aktvendimi dhe akti përcjellës ishin të nënshkruara. Po ashtu nga Inspektimi i lëndës është gjetur se veprimet (dështimet) e gjyqtarit A.G janë: 1. Dosjen e ka dorëzuar të pakompletuar te referenti përgjegjës, 2. Aktvendimi ka qenë i pa nënshkruar dhe i pa vulosur, 3. Akti përcjellës i datës 24.03.2023 me nr. 04117103 sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit të pandehurit nuk ka qenë i nënshkruar dhe i vulosur, 4. Konstatohet se gjyqtari nuk ka vepruar sipas vendimit të KGJK-së nr.424/2021 të datës 29.12.2021 për aprovimin e formës elektronike për procedimin e ankesave në lëmin penale gjatë procedurës paraprake në mes të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe procedimit të ankesave përmes SMIL-it në Gjykatën e Apelit, 5. Si shkelje në vazhdimësi konsiderohet veprimi i mëvonshëm apo nënshkrimi dhe vulosja e aktvendimit nga ana e gjyqtarit e cila ka

ndodhur pas kërkesës nga zyrtari përgjegjës i Gjykatës së Apelit drejtuar referentit D.S që të bëhet përmisimi i të dhënave edhe njëherë në sistemin SMIL, 6. Përveç mos kompletimit të dosjes me kohë, dokumenti - akti përcjellës ishte përsëritur tri herë. 7. Në dosjen origjinale përmbajtja e dokumentit kishte prioritet të lartë dhe numri i dokumentit ishte numër i ri për dallim nga dy dokumentet e regjistruara në sistemin SMIL 8. Si pasojë e veprimeve të lartcekura për të vepruar sipas afateve të përcaktuara ligjore me rastin e paraburgimit, Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore gjeti se ankesa është jo lëndore.

Me datë 06.06.2023 Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka kërkuar nga gjyqtarët që të deklarohen lidhur me raportin e Njësisë së Inspektimit Gjyqësor.

Me datë 07.06.2023 gjyqtari A.G ka dhënë deklaratë në të cilën ka theksuar se lënda në fjalë është proceduar me kohë në sistemin SMIL, me vonesë ka marr njoftimin që lëndët që janë me paraburgim duhet të jetë vendimi i nënshkruar dhe i vulosur dhe pasi të skenohet të ngarkohet në sistemin SMIL. Për këtë çështje më parë nuk kanë qenë të njoftuar dhe e kanë vendosur vendimin në sistem si çdo vendim tjetër. Ka shtuar se, pasi është ngarkuar vendimi në sistem nuk kanë mundur ta nënshkruajnë dhe vulosur deri sa është rregulluar nga ana e IT-ve dhe pastaj është ngarkuar i vulosur dhe i nënshkruar. Më tej ka theksuar se duhet të kenë aparate te skenimit më shumë nëpër gjykata edhe në zyre të gjyqtarit në mënyrë që pas përfundimit të rastit të kenë mundësi të skenojnë dhe të ngarkoj vendimin në SMIL. Tutje gjyqtari ka theksuar se, çka nëse janë në ditë vikendi duke punuar ndërsa aparati i skenimit gjendet në zyrën e referentit dhe vendimi mund të jetë i pa skenuar deri në ditën e parë të punës. Ka shtuar se, këto janë probleme teknike që duhet të zgjidhen duke ua mundësuar dy gjyqtarëve penalistë të kenë aparatin e skenimit në zyre dhe po ashtu sekretaret juridike të trajnohet për përdorimin e aparatit të skenimit e jo gjyqtari të merret me aspekte teknike.

Me datë 09.06.2023 gjyqtari S.S ka dhënë deklaratë në të cilën ka theksuar se programin SMIL e ka përdorur në shkallë të caktuar për ngarkim të aktgjykimeve, aktvendimeve dhe akteve shkresore të tjera por ka vështirësi të operoj në tërësi me këtë program dhe vazhdimisht gjyqtarët e Degës në Lipjan kërkojnë ndihmën e zyrtarit të IT. Ka shtuar se ai dhe gjyqtarët tjerë e njohin programin SMIL vetëm në hapa kryesor e jo në mënyrë të detajuar. Gjatë trajnimit nga zyrtarët e SMIL-it kanë mësuar vetëm ato hapa kryesor – si të ngarkohet aktgjykimi dhe aktvendimi pastaj edhe si të ndërmerren veprime për identifikimin e të dhënave nga prokuroria. Ka theksuar se, për aktvendimin në fjalë i është përvjedhur një gabim dhe ka ikur i pa nënshkruar dhe i pa vulosur pa e vërejtur dhe kjo ka ndodhur për shkak të vëllimit të lëndëve që ka, e sidomos në procedurë paraprake – me kërkesë për caktimin e paraburgimit sepse afati është i shkurtër dhe lënda me urgjencë. Më tej gjyqtari ka theksuar se nga praktika e mëhershme ka vepruar njësoj sikurse në lëndën PP.nr.17/23, mirëpo i ngarkon në SMIL menjëherë por meqenëse paraburgimet ndodhin të bien në vikende apo edhe në disa raste kur nuk ka internet ndodhë ashtu siç ka ndodhë në këtë rast që vendimi të ngarkohet në SMIL të nesërmen. Këto veprime i kryen referenti penal D.S. Ndërsa në rastin konkret e ka udhëzuar sekretaren juridike të ekspedon aktvendimin kurse sekretarja juridike e fut në lëndë aktvendimin pa nënshkrim duke harruar se aktvendimi ishte i pa nënshkruar ndërsa ai ka kontrolluar edhe një herë lëndën dhe pastaj ka nënshkruar. Nuk i shmanget asnjë lloj përgjegjësie që e ka. Tutje gjyqtari ka theksuar se kur është informuar, të gjitha rastet e lëndëve janë ngarkuar në SMIL siç edhe ka ndodhur, dhe aktvendimet e nënshkruara dhe të vulosura i skenon dhe sipas procedurës së ankesave i transferon/bartë në Gjykatën e Apelit përmes zyrës së referentit penal – përmes programit SMIL në hapin: “ekzekuto bartjen”. Ka shtuar se nuk ka pas neglizhencë në këtë rast, as qëllim tjetër,

ndërsa referentit penal ia ka përgatitur lëndën për Gjykatën e Apelit siç i ka dorëzuar përmes sekretares juridike ndërsa referenti ka deklaruar – ashtu siç ka deklaruar para zyrtarëve të inspeksionit – se lëndën e ka dërguar me prioritet në Gjykatën e Apelit. Po ashtu gjyqtari ka deklaruar se i pandehuri në lëndë Pp.nr.17/23 është liruar nga paraburgimi mirëpo është liruar me skadimin e kohëzgjatjes së paraburgimit sepse nuk ka pas kërkesë nga prokuroria për vazhdimin e paraburgimit.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të Raportit të Njësisë për Inspektim gjyqësor, dhe deklarimit të gjyqtarëve, ka gjetur se nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore ndaj gjyqtarëve S.S dhe A.G lidhur me lëndët PP.nr.17/23 dhe Pp.nr.18/23 cilat janë inicuar sipas detyrës zyrtare.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës PP.nr.17/23 me numër të SMIL 2023:070451 të cilat janë të bashkëngjitura në Raportin e Njësisë së Inspektimit Gjyqësor rezulton se ankesa e avokatit të së pandehurit në sistemin SMIL është regjistruar në afat kohor pra me datë 30.03.2023 me prioritet të lartë ndërsa te vërejtja se lënda është me paraburgim. Po ashtu me datë 30.03.2023 gjyqtari S.S – ashtu siç figuron nga historia e lëndës në SMIL – ka bartur lëndën te referenti D. S.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës PP.nr.18/23 me numër të SMIL 2023:071497 të cilat po ashtu janë të bashkëngjitura në Raportin e Njësisë së Inspektimit Gjyqësor rezulton se ankesa është paraqitur me datë 23.03.2023 dhe me datë 24.03.2023 përmes SMIL-it është përcjellë ankesa me prioritet të lartë dhe tek vërejtja figuron se ankesa është me paraburgim. Po ashtu me datë 24.03.2023 gjyqtari A.G – ashtu siç figuron nga historia e lëndës në SMIL – ka bartur lëndën te referenti D.S, kjo procedurë në të njëjtën datë është përsëritur dy herë.

Autoriteti Kompetent vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka gjetur se gjyqtarët S.S dhe A.G në mungesë të trajnimit të plotë dhe informacionit të qartë se si duhet të vendosen vendimet e procedurës paraprake në SMIL, po ashtu mungesa e trajnimit të stafit në këtë drejtim, mungesës së aparatit të skenimit dhe për shkak që nuk e kanë njohur në detaje procedurën e transferimit të ankesës në Gjykatën e Apelit përmes programit SMIL kanë vepruar sipas praktikës së deritanishme ku aktvendimet lidhur me paraburgimin – sikur të gjitha aktvendimet dhe aktgjykimet tjera – janë ngarkuar në sistemin SMIL të pa nënshkruara dhe të pa vulosura, mirëpo prioriteti i ekzekutimit/bartjes së lëndëve PP.nr.17/23 dhe PP.nr.18/23 – sipas historisë së lëndës ka qenë <u>prioritet i lartë</u> ndërsa fakti se në Gjykatën e Apelit prioriteti i këtyre lëndëve ka qenë prioritet mesatar mund të jenë si pasojë e një gabimi (error) momental të sistemit SMIL.

Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nëse prioriteti në këto dy lëndë në SMIL në Gjykatën e Apelit do të figuronte <u>prioriteti i lartë</u>, fakti se kanë qenë vendimet e pa nënshkruara dhe të pa vulosura do të mund të eliminoheshin përmes një komunikimi të menjëhershëm të referenteve përkatës të Gjykatës së Apelit me referentet përkatës të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, ashtu siç po veprohet edhe në raste tjera, pasi që kjo është procedure e re dhe ndonjëherë edhe ka lëshime por që po trajtohen rast pas rasti, por që asnjëherë nuk ka ndodh që lënda mos të trajtohet me kohë në Gjykatën e Apelit për shkak të gabimeve teknike me përjashtim të këtij rasti.

Sa i përket konstatimit të Raportit të Njësisë së Inspektimit Gjyqësor për dy lëndët PP.nr.17/23 dhe PP.nr.18/23 se shkelje në vazhdimësi konsiderohet veprimi i mëvonshëm apo nënshkrimi dhe vulosja e aktvendimit nga ana e gjyqtarëve e cila ka ndodhur pas kërkesës nga zyrtari

përgjegjës i Gjykatës së Apelit drejtuar referentit D.S që të bëhet përmisimi i të dhënave edhe njëherë në sistemin SMIL, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se ky fakt nuk mund të konsiderohet si shkelje në vazhdimësi sepse gjyqtarët duke mos i njohur procedurat teknike në mënyrë detale në programin për transferimin e ankesës kanë vepruar sipas udhëzimeve të zyrtarit përgjegjës së Gjykatës së Apelit.

Po ashtu Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vëren se në rastit e dy lëndëve Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e paraburgimit dhe pas skadimit të kohëzgjatjes së paraburgimit të pandehurit janë liruar. Për më tepër në lëndën PP.nr.17/23 (2023:070451), e cila lëndë pas ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka marr numrin manual P.nr.216/23 është vendosur me aktgjykimin e datës 06.04.2023 ndërsa në lëndën PP.nr.18/23 (2023:071497) e cila lëndë pas ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka marr numrin manual P.nr.205/23 është vendosur me aktgjykimin e datës 25.04.2023.

Duke u bazuar në rrethanat e lartcekura, duke i pasur parasysh veprimet e ndërmarra dhe provat e grumbulluara në fazën hetimeve preliminare të iniciuara sipas detyrës zyrtare, rezultoi se në veprimet e gjyqtareve S.S dhe A.G nuk ka shkelje disiplinore të parashikuar me nenin 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me procedurën e inicuar sipas detyrës zyrtare, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme se gjyqtarët S.S dhe A.G kanë kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 2, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi..

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/12/23, me datë 23.06.2023

Albina Shabani Rama

_____

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë